



Сектор за труд

Сектори i Punës

Në bazë të nenit 55 të Ligjit për Organizimin dhe Punën e Organeve të Administratës Shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10, 51/11 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/19, 110/19 dhe 121/24), dhe nenit 9 të Ligjit për udhëzimin e punëtorëve nga Republika e Maqedonisë së Veriut në shtete të tjera për realizimin e punëve ndërtimore përmes kontratave të projektit dhe për ushtrimin e punëve të tjera sezonale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 166/12 dhe 30/16), Ministria e Ekonomisë dhe Punës shpall

THIRRJE PUBLIKE

për mbledhjen e kërkesave nga personat e interesuar juridikë për pjesëmarrje në shpërndarjen e së drejtës së udhëtimit të punëtorëve (detashman) për realizimin e kontratave të projektit në RF të Gjermanisë, edhe atë për:

- 120 punëtorë për kontratat e projektit të izolimit;
- 110 punëtorë për kontratat e projektit të montimit dhe
- 320 punëtorë për kontratat e projekteve ndërtimore.

Në bazë të nenit 5 të Ligjit për udhëzimin e punëtorëve nga Republika e Maqedonisë në shtetet tjera për realizimin e punëve ndërtimore përmes kontratave të projektit dhe për ushtrimin e punëve të tjera sezonale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 166/12 dhe 30/16), në shpërndarjen e së drejtës për një kuotë të caktuar të punëtorëve për realizimin e punimeve ndërtimore, montuese dhe izoluese përmes kontratave të projektit, mund të marr pjesë shoqëria tregtare e cila:

- është e pajisur në aspektin kadrovik dhe teknik për realizimin e pavarur të kontratave konkrete të projektit jashtë vendit dhe që plotëson kushtet e tjera të përcaktuara me këtë ligj;
- ka veprimtari të regjistruar në fushën e ndërtimtarisë;
- ka të paktën dhjetë të punësuar me afat të pacaktuar, gjashtë muaj para se të lajmërohet në thirrjen publike;



Сектор за труд

Sektori i Punës

- ka bonitet pozitiv në punë në vitin paraprak;
- ka shlyer të gjitha tatimet, kontributet dhe taksat tjera publike;
- kundër të cilit nuk është hapur asnjë procedurë falimentimi dhe
- kundër të cilit nuk është filluar procedurë e likuidimit.

Për pjesëmarrjen në shpërndarjen e së drejtës për kuotën e caktuar të punëtorëve, për realizimin e kontratave të projektit ndaj personave juridikë, në kuadër të së drejtës së dhënë nga Republika Federale e Gjermanisë deri më 30 shtator të vitit 2026, shoqëria tregtare duhet të dorëzojë në Ministrinë e Ekonomisë dhe Punës:

- kërkesë nga shoqëria tregtare me prezantimin e saj, emërtimin e saj, adresën, selinë, personin e autorizuar të shoqërisë tregtare, telefonin, e-mailin si dhe numrin dhe llojin e punëtorëve për të cilët aplikohet;
- dokument për veprimtarinë e regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose dokument për gjendjen rrjedhëse të personit juridik;
- dokument për numrin e përgjithshëm e të punësuarve në shoqëri, nga të cilët të paktën dhjetë punëtorë të jenë të punësuar për kohë të pacaktuar, të paktën gjashtë muaj para lajmërimit të shoqërisë në thirrjen publike;
- Formulari M-1/M-2 për numrin e përgjithshëm e të punësuarve në shoqërinë tregtare, me pasqyrë të lajmërimeve/çlajmërimeve në sigurimin e detyrueshëm social për shoqërinë, të lëshuar nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- dokument për bonitet të shoqërisë, të lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut (Informacion për gjendjen ekonomike dhe financiare);
- vërtetim nga Drejtoria e të Ardhurave Publike për tatimet, kontributet dhe taksat tjera të paguara publike;
- vërtetim nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut se nuk është nisur procedurë e likuidimit dhe procedurë e falimentimit;
- referenca të shoqërinë tregtare brenda dhe jashtë vendit, të nënshkuara dhe të vërtetuara nga punëdhënësi.

Dokumentet e përmendura nuk duhet të jenë më të vjetra se gjashtë muaj nga data e lëshimit, ndërsa duhet të dorëzohen në original ose kopje të vërtetuara nga një noter në zarf të mbyllur.



Сектор за труд

Sektori i Punës

Afati për parashtrimin e kërkesave për pjesëmarrje në ndarjen e kuotës së dhënë të thirrjes publike nga shoqëritë e interesuara tregtare është 15 ditë, duke llogaritur nga dita e radhës nga dita e shpalljes së thirrjes publike.

Kërkesat që do të mbërrijnë pas afatit të dorëzimit, do të konsiderohen si të vonuara dhe nuk do të merren parasysh.

Kërkesat duhet të dorëzohen përmes postës në Ministrinë e Ekonomisë dhe Punës: Rruga "Juri Gagarin" numër 15 - Shkup ose të dorëzohen në arkivin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës të Republikës së Maqedonisë së Veriut (jo më vonë se ora 16:00, çdo ditë pune).

Informacione në adresën si vijon maja.papatolevska@economy.gov.mk